

VENDIM
Nr.428, datë 5.10.1992

**PËR KRITERET E DHËNIES SË PËRKRAHJES EKONOMIKE FAMILJEVE
FSHATARE ME SIPËRFAQE TË KUFIZUARA TOKE DHE TË ARDHURA TË
PAKËTA**

Në zbatim të nenit 5 të ligjit nr.7501, datë 19.7.1991 "Për tokën", me propozimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit, të Ministrisë së Punës, të Përkrahjes Sociale, Emigracionit e të Përndjekurve Politikë dhe të Ministrisë së Financave e të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Familjeve fshatare të zonave kodrinore-malore e verilindore të vendit të cilat kanë deri në 2000 m² sipërfaqe për frymë, shteti u jep përkrahje ekonomike.

2. Masa e përkrahjes ekonomike jepet në raport me sipërfaqen e tokës dhe cilësinë e saj, sipas pasqyrës nr. 1 që i bashkëngjitet këtij vendimi.

3. Familjet fshatare që kanë nga një pjesëtar në marrëdhënie pune me shtetin ose përfitojnë asistencë sociale nga puna në shtet, nuk marrin përkrahje ekonomike. Këtu përfshihen edhe specialistët e lartë të bujqësisë që përfitojnë asistencë sociale shtetërore.

4. Familjet fshatare që kryejnë veprimtari private jobujqësore ose kanë pjesëtarë në të tilla veprimtari, e përfitojnë përkrahjen ekonomike nga shteti deri 3 muaj pas regjistrimit në organet shtetërore.

5. Familjeve që marrin pension nga shteti u bëhet zbritje në masën e përkrahjes, në varësi nga madhësia e pensionit, sipas pasqyrës nr.2 që i bashkëngjitet këtij vendimi.

6. Përcaktimi i familjeve dhe numri i personave që përfitojnë përkrahje ekonomike, bëhet nga këshilli i komunës.

Në komunat ku ka shumë familje që përfitojnë përkrahje sociale, këshilli i rrethit ka të drejtë të caktojë pranë komunave një specialist bujqësor të papunë, duke e paguar sipas atestimit përkatës.

7. Për përfitimin e përkrahjes ekonomike kryefamiljari është i detyruar të paraqesë pranë komunës këto dokumente:

a. Kërkesën për të drejtën e përfitimit të përkrahjes ekonomike në bazë të këtij vendimi.

b. Tapinë e tokës, ose vërtetimin e lëshuar nga komisioni i tokës.

c. Deklaratën që nuk siguron të ardhura nga puna e përhershme ose stinore në shtet e nga asistencë sociale shtetërore, si dhe deklaratën e fillimit të veprimtarisë private jobujqësore, të regjistruar në organet shtetërore.

d. Librezën e pensionit dhe dokumente të tjera për të ardhurat që përfitojnë nga sigurimet shoqërore.

e. Deklaratën e gjendjes familjare

8. Për çdo ndryshim të të ardhurave dhe të gjendjes familjare kryefamiljari është i detyruar të njoftojë brenda 15 ditëve këshillin e komunës.

9. Këshilli i komunës i paraqet çdo muaj zyrës së financës në këshillin e rrethit një kopje të listëpagesës për përkrahjen ekonomike për çdo familje dhe në total.

Zyra e financës kontrollon dhe çel çdo muaj fondet përkatëse për përkrahjen ekonomike pranë degëve të bankës në rrethe e rajone, sipas miratimit të këshillit të rrethit.

10. Përkrahjen ekonomike e përfitojnë familjet që kanë marrë tokë me tapi të rregullt, kurse familjet e tjera, të cilave u takon ndihmë, pas marrjes së tapisë së rregullt.

Gjithashtu përkrahje ekonomike përfitojnë të gjitha familjet që kanë mbetur me pak tokë,

si pasojë e zhvendosjes së tyre nga ndërtimi i veprave ujore etj.

11. Shkelja e kriterëve sipas pikave nr.1, 3, 4 e 6 të këtij vendimi, kur nuk përbën vepër penale, dënohet nga zyrat e financës si kundërvajtje administrative me gjobë deri në 1000 (një mijë) lekë.

Kundër vendimit të dënimit mund të bëhet ankim, brenda 10 ditëve nga shpallja ose njoftimi i tij, te kryetari i këshillit të rrethit, akti i të cilit është i formës së prerë.

12. Përkrahja ekonomike që do t'i jepet familjeve me pak të ardhura në fshat, të përballohet nga buxheti i shtetit.

13. Fondi i financimit për përkrahjen ekonomike në fshat caktohet 150 milionë lekë deri më 31 dhjetor 1992.

14. Këshillat e rretheve dhe të komunave parashikojnë punësimin në veprat ose objektet e reja që do të ndërtohen në zonën e tyre, në radhë të parë, të krahëve të punës nga familjet që përfitojnë përkrahje ekonomike.

15. Ministrinë dhe institucionet e tjera qendrore në bashkëpunim me këshillat e rretheve, gjatë përcaktimit të veprave që do të ndërtohen në vitet e ardhshme, të shohin me përparësi punësimin e njerëzve në rrethe e zona me më shumë probleme.

16. Madhësia dhe kriteret e dhënies së kësaj asistence të rishikohen në dhjetor të vitit 1992.

17. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Financave dhe e Ekonomisë, Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit, Ministria e Punës, e Përkrahjes Sociale, Emigracionit dhe e të Përndjekurve Politikë, Banka e Shtetit Shqiptar dhe komunat e rrethet.

18. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.413, datë 12.11.1991 "Për kriteret e dhënies së përkrahjes ekonomike familjeve fshatare më sipërfaqe të kufizuar toke dhe të ardhura të pakëta", shfuqizohet.

19. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.324, datë 24.7.1992 "Për ndryshimin e çmimeve të disa artikujve e tarifave që nuk liberalizohen", pika 6 shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe efektet e tij shtrihen nga data 1 tetor 1992.

Përgjatshimisht në fshatin Shtoi i Vogël efektet e këtij vendimi do të fillojnë nga data 1 maj 1992.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Aleksandër Meksi

PASQYRA NR. 1

MASA E PËRKRAHJES EKONOMIKE PËR FAMILJET FSHATARE ME SIPËRFAQE TOKE TË PAKËT DHE TË ARDHURA TË KUFIZUARA

Pjelloria e tokës sipas klasifikimit

Sipërfaqja për m ² Për frymë	Grupi I-II	Grupi III-IV	Grupi V	Grupi VI-VII	Grupi VIII-IX
1. 0-250 m ²	95	110	125	140	155
2. 251-500 m ²	75	90	105	120	135
3. 501-750 m ²	50	70	75	100	115
4. 751-1000 m ²	35	50	65	80	95
5. 1001-1250 m ²	15	30	45	60	75
6. 1251-1500 m ² -		15	25	40	55
7. 1501-1750 m ² -		-	20	20	35

8. 1751-2000 m ² -	-	-	10	20
-------------------------------	---	---	----	----

PASQYRA NR. 2
ZBRITJA QË I BËHET PËRKRAHJES EKONOMIKE NË FSHAT PËR EFEKT TË
PENSIONEVE

E ardhura e drejtpërdrejtë Mujore për frymësë Nga pensionet (në lekë)	Zbritja që i bëhet vlerës përkrahjes ekonomike për frymë nga pasqyra nr. 1 (në lekë)
Deri në 100	Nuk bëhet zbritje
101-150	25
151-200	50
201-250	90
251-300	130
301-350	170
351 e lart	Nuk përfiton ndihmë